

THIRRJE PËR KONKURS

FOTOGRAFIE PËR TË PROMOVUAR VENDET E TRASHËGIMISË KULTURORE NË KOSOVË

Nëse jeni student i vitit të fundit të Programit Master në Trashëgimi Kulturor dhe Menaxhim të Turizmit në Universitetin e Prizrenit dhe ju intereson trashëgimia kulturore dhe fotografia, aplikoni për të marrë pjesë në foto konkursin tonë, i cili synon promovimin dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe fetare në Kosovë. Me ndihmën e menaxhmentit të Fakultetit, 5 studentë do të përzgjidhen dhe do të ftohen që të:

1

Vizitojnë vende të trashëgimisë kulturore në mbarë Kosovën për një seancë njëditore fotografimi dhe mësojnë rreth këtyre vendeve.

2

Dorëzojnë pesë fotografi për konkurs. Tridhjetë (30) fotografitë më të mira do të përzgjidhen nga komisioni i përbërë nga përfaqësues të Misionit të OSBE-së në Kosovë dhe Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

3

Marrin pjesë në foto ekspozitat e lëvizshme të cilat do të mbahen nëpër Kosovë ku 30 fotografitë e përzgjedhura do të ekspozohen dhe do të jenë në dispozicion për blerje.

Paratë nga shitjet e mundshme gjatë ekspozitave do t'i takojnë autorit të fotos. Transporti tek objektet e trashëgimisë kulturore dhe shtypja e fotografive të përzgjedhura do të sigurohen nga Misioni i OSBE-së në Kosovë.

Për të aplikuar apo për informacione të mëtejshme, ju lutem kontaktoni Arijeta Rrotllën, në arijeta.rrotlla@osce.org; ose Arta Gashin në arta.gashi@osce.org, nga 18 maj - 7 qershor 2015

Për të marrë pjesë në këtë aktivitet, ju duhet pajtoheni që do të:

- Dorëzoni fotografitë tuaja personale dhe nuk do t'i shkelni të drejtat e autorit;
- Dorëzoni fotografitë e bëra me aparat fotografik me të paktën tetë mega pixel;
- Dorëzoni fotografitë në formatin JPG;
- Pajtoheni që OSBE të mbajë të drejtën për të botuar fotografitë tuaja.